

VENDIM
Nr. 179, datë 29.6.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 158, DATË 5.6.2026,
“MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
‘GREENSOL’ SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/6 prot., datë 25.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 5.6.2026, ‘Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Greensol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Greensol” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greensol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.6.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës, duke shtuar në të dhe elementet e depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar asnjë element tjetër teknik të aplikimit të saj. Për këtë shoqëria ka kryer dhe pagesën përkatëse që i korrespondon modifikimit të licencës, sipas përcaktimeve të aneksit A të licencës.

- Për sa kërkuar dhe në rrethanat kur shoqëria nuk është licencuar ende, vlerësohet se kemi të bëjmë me një ka përditësuar projektin e centralit fotovoltaiik të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Greensol” sh.p.k., me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, duke përfshirë tanimë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Sikurse argumentuar nga shoqëria dhe për sa konstatuar dhe nga ana jonë, nëpërmjet VKM-së nr. 770, datë 19.12.2025 dhe në kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.2.2026, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria ka marrë të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 49.96 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

- Po ashtu, në nenin 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, parashikohet se: “Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin

objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit, duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet”.

- Rezulton se shoqëria ka paraqitur kërkesën për përfshirjen e veprave ndihmëse për një kapacitet dukshëm më të madh se kapaciteti i instaluar i centralit, por ERE do të pranojë për shqyrtim në këtë fazë vetëm për fuqinë 49.96 mw dhe në vijim, do të zhvillohet korrespondenca përkatëse me shoqërinë për të saktësuar/sqaruar elementet dhe dokumentacionin e kësaj kërke.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet i nevojshëm ndryshimi i paragrafit të parë, në pjesën e konstatimeve, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 158/2026, si vijon:

Shoqëria “Greensol” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, ndaj sikurse parashtruar e vlerësuar, jemi në rrethanat e ndryshimit të vendimit nr. 158, datë 5.6.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 5.6.2026, si vijon:

a) paragrafi i parë, pjesa e konstatimeve, i vendimit të Bordit nr. 158, datë 5.6.2026, ndryshon dhe bëhet:

- Shoqëria “Greensol” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. ERE do të pranojë për shqyrtim në këtë fazë përfshirjen e veprave ndihmëse vetëm për fuqinë 49.96 mw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Greensol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

